

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 891120
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **OB614-20-6780-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Labaorator për Analiza për kryerjen e testeve SARS-COV 2**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ntsh "AtomMed"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: Uran Tinova p.n

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049530552

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Donika Prekadini

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

atommed@hotmail.com

(Adresa elektronike)

05.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit



Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Adresa elektronike)

(Numri i faks-it)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- Njoftimi për kontratë me dt. 27.10.2020 përmes prokurimit elektronik
- Kërkesa për informacione shtesë dt. 30.10.2020
- Kërkesa për ri-shqyrtim dt. 02.11.2020
- Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt. 03.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	--	----	--------------------------

--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	--	--	--	----	--------------------------

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 4.1 i RRUOPP

Neni 4.4 i RRUOPP

Neni 18.9 i RRUOPP

Neni 20.8 i RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, Ju njoftojmë se Komuna e Obiliqit me dt.27.10.2020, për këtë aktivitet të prokurimit e ka publikuar Njoftimin për Kontratë në platformën elektronike, përmes *Procedurës së Hapur*.

Ne jemi shumë të interesuar që të jemi pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duke paraqitur ofertën tonë, dhe të jemi të barabartë me të gjithë Operatorët tjerë Ekonomik, por këtë po e kemi të pamundur për shkak të specifikave të cilat janë diskriminuese dhe favorizuese, përveq tjerash janë shumë kuptimshme, dhe favorizuese për prodhues të caktuar dhe specifika të cilat nuk lejojnë të jenë të barasvlefshme apo edhe më të avansuara. Duke i nisur nga ky fakt, pretendojmë se, Komuna e Obiliqit ka përdorur specifikimet teknike që i janë pershtatur prodhuesëve të caktuar me ç'rast na ka pamundësuar pjesëmarrjen tonë në këtë aktivitet të prokurimit por edhe OE tjerë, duke bërë kufizim të konkurrencës dhe duke ngushtuar tregun. Ngase këto specifikacione janë të dedikuara për serinë e paisjeve **Vidas** nga **Prodhuksi Biomerieux** - shih linkun: <https://www.biomerieux-diagnostics.com/vidasr-3>

Ne përmes Kërkesës për ri-shqyrtim të paraqitur më dt. 02.11.2020, në Komunën e Obiliqit për këtë aktivitet të prokurimit, kemi kërkuar që specifikimet teknike të ndryshohen apo të gjeneralizohen dhe mos të bëhen diskriminime të panevojshme dhe në dëm të OE, por edhe në dëm të Buxhetit të Kosovës dhe të vet Komunës.

Me dispozitat e prokurimit publik përshtatja e specifikimeve është në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 të LPP-së ku shkruan *“Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.*

Po ashtu, autoritetit kontraktues i ndalohet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

Edhe me nenin 20.8 të RRUOPP citon: *“Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlerëshme/ekuivalente”.*

Ne, edhe përmes kërkesës për informacione shtesë të dt. 30.10.2020, por edhe përmes kërkesës për ri-shqyrtim e kemi informuar për këtë diskriminime por edhe kemi kërkuar edhe sqarime, si dhe riformulime apo ndryshime të këtyre specifikime, në këto përshkrime të pozicionit sa i përket:

"Kapaciteti minimal 10 analiza të njëjta ose të ndryshme për një ose më shumë mostra". Kemi kërkuar të sqarohet sepse ka kuptime të shumta.

"Teknologjia e punës së analizatorit : metoda ELFA (Enzyme Linked Fluorescent Assay- sistem i Automatizuar Imunoassay bazuar në parimet e analizës Fluoroshente të lidhur me Enzimen)". Kemi kërkuar mundësin e ofrimit të teknologjisë së punës me metoda të tjera ekuivalente si: CLIA, ECLIA apo CMIA pra ekuivalente, apo me të avancuara pasi që shumica e Top Brendeve perdorin metodat e lartecekura.

"D.Dimer EXCLUSION II" Kemi kërkuar që ky pershkrim "EXCLUSION II" të hiqet nga specifikat pasi që nuk paraqet ndonjë kualitet ndryshe apo me të avancuar. Per me teper paraqet vetem nje dedikim per nje prodhues te caktuar. I cili është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së, si dhe me cdo dispozitë tjetër ligjore për shkak të diskriminimit dhe favorizimit që paraqet.

"E mbështetur në certifikatën ISO 15189" Kemi kërkuar sqarim sepse ky standard është per akreditim te Laboratoreve Mjekesore. Si eshte menduar kjo mbeshtetje apo qertifikat gjate tranimit.

Në më dt.03.11.2020, pas orës 16:00, kemi pranuar vendimin e Komunës për refuzimin e kërkesës tonë për ri-shqyrtim, refuzim të cilin e kemi prit sepse vetë specifikimi të tregon se këtu nuk ka të bëjë me profesionalizmin e njësisë kërkuese, por me profesionalizmin e mundshëm të OE të cilët ja kanë ofruar specifikimin Komunës së Obiliqit.

Ne shprehim shqetësimin tonë lidhur me këtë, pasi që kjo është bërë e qëllimshme, duke bllokuar tregun, eliminuar konkurrencën dhe pamundësinë e ardhjes së një oferte më të mirë dhe më të favorshme. Ku të gjitha aktet legjislative primare dhe sekondare të Prokurimit Publik, e ndalojnë përgatitjen e Dosjes së Tenderit që në një mënyrë favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial. Kjo është e cekur edhe në **Nenin 7 të LPP-së**, Është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu, në **nenin 7 paragrafi 6, I LPP-së** citon: "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Madje edhe parim i direktivave të BE-se, është se: "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."

Po ashtu edhe me **nenin 4.4 të RRUOPP** e obligon që Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesit potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Gjithashtu **neni 18.9 i RRUOPP-së** përcakton qartë "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Lidhur me të gjitha këto parregullësi, Komuna e Obiliqit, përveç shkeljeve të lartpërmendurs, në mënyrë direkte ka bërë edhe shkelje tjera të këtyre dispozitave të prokurimit publik, e të cilat janë:

Neni 1 i LPP-së, e obligon që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 i LPP-së, e obligon që të siguron që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Dhe jo të veprohet edhe më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, ku ju, si autoritet kontraktues rrezikoni seriozisht të dëmtoni buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për OE të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së.

Neni 4.1 i RRUOPP-së, citon "AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merrr:

VENDIM

APROVOHET: Ankesa e OE Ntsh "AtomMed" si e bazuar

ANULOHET: ky aktivitet i prokurimit apo të ndryshohen specifikimet teknike duke i gjeneralizuar më tepër konform dispozitave të LPP-së dhe të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Neve si Operator ekonomik na janë bërë dëme materiale dhe jomateriale. Për përgatitjen rreth këtij aktiviteti, shpenzime të letrës, stafit, si dhe shpenzime në përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, diku në vlerë rreth 2,000.00 €.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*